



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 457/7 prot.

Tiranë, më 22.11.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 703, datë 28.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.11.2023, është njoftuar vendimi nr. 703, datë 28.9.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.11.2023, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 8.11.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 703, datë 28.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Salavaçi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Suela Salavaçi*”², ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit³, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela *** Salavaçi*”.

2.3 **KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁴ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Suela Salavaçi.

3. **Gjetje të ONM-së**. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “b” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se vëzhguesi ndërkombëtar i ka përcjellë Komisionit *Gjetjen me nr. 398 prot., datë 27.6.2023*, me qëllim analizimin e procedimit penal nr. ***/2010, të pushuar nga subjekti i rivlerësimit.

4. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit, kryesisht për subjektin e

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.4.2018.

³ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë **.10.2017. Deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. ***, datë **.5.2021.

⁴ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.2.2023.

rivlerësimit Suela Salavaçi dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit, miratuar me shumicë votash nga paneli, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47, të Kodit të Procedurave Administrative, dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

5. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

5.1 *Për vlerësimin e pasurisë.* Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, fakteve dhe rrethanave të konstatuara në vlerësimin e komponentit të pasurisë, arrin në përfundimin se, nga kontrolli i pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e pasurisë, si dhe nuk ka kryer deklaram të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

5.2 *Për kontrollin e figurës.* Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Formulari i deklaramit për figurën është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

5.3 *Për vlerësimin e aftësive profesionale.* Lidhur me këtë kriter, sipas shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar e aftë profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka çmuar të referojë pranë organit kompetent ILD, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me kallëzimin e regjistruar nr. ***, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

6. *Vendimi i Komisionit.* Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash⁵, ka vendosur:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

*2. Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent ILD, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me kallëzimin e regjistruar nr. ***, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.*

⁵ Anëtare në pakicë, Komisionere Etleda Çiftja.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

7. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁶ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁷ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 8.11.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, ndaj vendimit nr. 703, datë 28.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi (bashkëlidhur këtij ankimi).

7.1 Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë Rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ, mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe burimet e pretenduara për krijimin e tyre, si dhe në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, pasi vendimi i Komisionit nuk paraqet analizë të kënaqshme të çështjeve të trajtuara.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

11. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 703/2023, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 703/2023, të Komisionit, në tërësinë e tij.

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

⁷ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

13. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje dhe të Rekomandimit të ONM-së, lidhur me shpjegimin bindshëm të ligjshmërisë të burimit të krijimit të pasurive të subjektit, ndër të tjera, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”, kanë deklaruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme apo vlera të ndryshme të konsiderueshme, me burim krijimi të ardhurat nga prindërit e subjektit, si më poshtë listuar:

(i) Apartament banimi në Tiranë, në shumën 38.800 USD; (ii) Apartament banimi në ***, në shumën 72.000 euro; (iii) Depozitë bankare dyemërore, në shumën 67.496 USD; (iv) Dy llogaritë e vajzave, deklaruar në Deklaratën “Vetting” 2017, në shumën totale prej rreth 18.200 USD; (v) Shumat 6.000 euro në vitin 2007 dhe 5.000 euro në vitin 2008, 10.000 USD në vitin 2010; (vi) Shumën prej 10.000 USD, deklaruar dhuruar subjektit dhe poseduar si likuiditet në formën *cash*, në Deklaratën “Vetting” 2017.

15. Përveç sa më sipër deklaruar, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se me (vii) kontratën e dhurimit nr. *** rep. /*** kol., datë **.4.2017, subjekti është bërë përfutuese e banesës 2-katëshe në Tiranë,⁸ me vlerë të llogaritur sipas EKB-së rreth 7 milionë lekë, dhe (viii) nëpërmjet vendimit të çeljes së trashëgimisë ligjore nr.***rep./** kol., datë **.2.2021, subjekti është bërë përfutuese e pjesës takuese 1/3 të depozitës bankare, në emër të babait pranë *** Bank, në shumën 60.857 USD, depozitë që e ka origjinën e krijimit në vitin 2003.

16. Në këto rrethana, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe të jurisprudencës së Kolegjit, kryerja e analizës mbi besueshmërinë e deklarimit të subjektit, do shtrihet mbi të gjitha pasuritë e subjektit të rivlerësimit, të dokumentuara nga aktet në dosje, për të cilat ka deklaruar si burim të ardhurat e prindërve, në cilësinë e personave të lidhur/tjerë të lidhur me të.

17. Pasuria nr.1, Apartament banimi në rrugën “*** **”, në Tiranë

17.1 Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sip. 121.36 m,² me adresë rrugën “*** **”, blerë sipas kontratës së shitjes nr. *** kol./*** rep., datë **.11.2013, në vlerën 38.800 USD, dhe deklaratës noteriale nr. *** kol./*** rep., datë **.11.2013⁹.

⁸ Në këtë banesë, subjekti ka jetuar vazhdimisht me prindërit dhe, me aktin Kontratë dhurimi pasurie, datë **.4.2017, kjo pasuri i është dhuruar subjektit të rivlerësimit nga prindërit, ***. e ***. Salavaçi.

⁹ ASHK Tiranë Veri ka konfirmuar pasurinë *apartment me sipërfaqe 121,36 m²*, me nr. **/***+***-***, vol. ***, fq.***, z. k. ***, në Tiranë, të regjistruar në emër të Suela Salavaçi.

Apartamenti është porositur dhe paguar nga nëna ime sipas kontratës së porosisë datë **.3.2005. Burimi i krijimit: Të ardhura të familjes, nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme etj. Pjesa takuese 100%.

17.2 Në DV-2013, subjekti ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në vlerën 38.800 USD dhe pjesë takuese 100%, pa deklaruar burimin e krijimit të saj.

17.3 Nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se vetë subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, ka lidhur *kontratën e shitblerjes nr. rep.***, nr. kol. ***, datë **.11.2013*, me shitësin, shoqëria ndërtuese “***.” sh.p.k. dhe investitorin ***. ***, për shitjen e pasurisë apartament, në rrugën “*** **”, Tiranë, për çmimin 38.800 USD, *të cilin Suela Salavaçi ia ka likuiduar totalisht investitorit ***. ***, përpara regjistrimit të këtij apartamenti në ZVRPP Tiranë dhe jashtë zyrës noteriale.*

17.4 Nga hetimi administrativ për këtë pasuri, përveç sa më sipër, kanë rezultuar dhe:

(1) *Kontratë porosie*, datë **.3.2005, vënë në dispozicion nga subjekti, midis nënës së subjektit, *** ***, në cilësinë e porositëses, shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. (të përfaqësuar nga administratori, z. ***. ***) dhe investitorin, z. ***. ***, për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 137,5 m² dhe sipërfaqe shfrytëzimi 107,59 m², në adresën rruga “***. ***” (*** **). Palët kanë përcaktuar çmimin e apartamentit në vlerën 38.800 USD, e cila është likuiduar totalisht nga blerësja *** ***, në favor të investitorit, në momentin e nënshkrimit të kontratës.

(2) *Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.11.2013*, ku nëna e subjektit, znj. ***. ***, ka hequr dorë nga pronësia e apartamentit duke ia dhuruar vajzës së saj, Suela Salavaçi. Njëkohësisht, shoqëria ndërtuese dhe investitori kanë shprehur dakordësinë për kalimin e pronësisë së apartamentit nga ***. ***, në favor të Suela Salavaçi, si dhe kanë vendosur të shfuqizojnë kontratën e porosisë datë **.3.2005.

(3) *Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2022*, lëshuar nga investitori ***. ***, i cili, ndër të tjera, deklaroi se çmimi i shitblerjes së apartamentit prej 38.800 USD është likuiduar nga blerësja ***. ***, në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, datë **.3.2005.

17.5 Për sa i përket burimeve të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni, për shkak se pasuria është deklaruar e likuiduar me të ardhurat e nënës së subjektit, e ka konsideruar znj. ***. ***. “*person tjetër të lidhur*”, në kuptim të nenit 3/14, dhe si dhuruese bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, dhe i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të nënës, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit.

17.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar fillimisht se nuk mund të identifikojë një burim specifik që shërbeu për blerjen e apartamentit, pasi nëna ka pasur të ardhura të ndryshme me të cilat ka krijuar pasuritë.

17.7 Në pyetësorët në vijim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të deklarojë dhe të dokumentojë çdo investim të prindërve në pasuri të luajtshme e të paluajtshme, si dhe të dokumentojë çdo të ardhur të ligjshme të prindërve të saj, likuiditetet në banka etj.

17.8 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka depozituar pranë Komisionit të tjera dokumente mbi të ardhurat e prindërve të saj, pasuritë e krijuara prej tyre dhe likuiditetet gjendje.

17.9 Komisioni, fillimisht, ka analizuar të ardhurat e prindërve për blerjen e apartamentit në shumën 38.800 USD deri në datën **.3.2005, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme vetëm të ardhurat që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D/3 të aneksit të Kushtetutës, ku ka rezultuar se prindërit nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet në pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me balancë negative të mbartur ndër vite, deri në shumën totale – 6.155.058 lekë.

17.10 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi ka rezultuar: (i) *Ka deklarim të pasaktë të pasurisë, pasi në DPV-në e vitit 2013 nuk është deklaruar burimi i krijimit;* (ii) *Në përmbajtje të kontratës së porosisë datë **.3.2005, përcaktohet se nëna dhe investitori kanë vendosur të prishin kontratën e datës **.2.2005. Subjekti të depozitohet kopje të kësaj kontrate të shfuqizuar midis palëve¹⁰;* (iii) *Prindërit e subjektit kanë rezultuar me balancë negative nga analiza e kryer, për blerjen e apartamentit.*

18. Pasuria apartament me sipërfaqe 84 m², 2+1, në ***

18.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament me sipërfaqe 84 m², 2+1, blerë sipas kontratës së porosisë nr. ***/**, datë **.3.2012, në vlerën 72.000 euro, apartament i porositur nga babai, *** ***, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë **.2.2005 dhe kontratës së porosisë nr. ***/**, datë **.10.2010. Burimi i krijimit: Të ardhura të familjes, nga kontratat e qirave; shitja e pasurive të paluajtshme; të ardhura nga vëllai në Itali, etj.¹¹. Vlera: 72.000 euro. Pjesa takuese: Nuk është regjistruar”.*

18.2 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Kontratë porosie apartament 2+1. Vlera 72.000 euro. Pjesa në %: 100%”.* Subjekti për këtë pasuri nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Ndërsa, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *“Apartament 2+1. *** ** - Babai”.*

18.3 Nga verifikimi i akteve në dosje, ka rezultuar se vetë subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar, në cilësinë e porositëses, një *Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2012, me sipërmarrës ***. ***. dhe shoqërinë ndërtuese “****”, i përfaqësuar nga administratori ***. ***.*

18.4 Për sa i përket mënyrës së likuidimit të pagesave për blerjen e kësaj pasurie, palët kanë përcaktuar se çmimi i blerjes së apartamentit është në vlerën prej 72.000 euro, e cila do të paguhet me këste si vijon:

*1- Kësti i parë, në vlerën prej 37.000 euro, është shlyer më datë **.10.2010,¹² në mbështetje të kontratës nr.*** rep., nr. *** kol., datë **.10.2010, pa asnjë pretendim të mëtejshëm financiar nga palët;*

¹⁰ Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontrata e datës **.2.2005, nuk gjendet.

¹¹ Referohuni dokumentit bashkëlidhur deklaratës lidhur me burimin e krijimit.

¹² Ku në cilësinë e porositësit është babai i subjektit, shtetasi ***. ***.

- 2- *Kësti i dytë, në vlerën 25.000 euro, është likuiduar nga z. ***, ***, në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, në datën **.3.2012;*
- 3- *Kësti i tretë, në vlerën 2.000 euro, do të shlyhet deri më datë **.5.2012;*
- 4- *Kësti i katërt, në vlerën 2.000 euro, do të shlyhet me daljen e dokumentacionit të pronësisë nga ZVRPP Kavajë.*

18.5 Nga hetimi administrativ për këtë pasuri, përveç kontratës si më sipër, kanë rezultuar edhe:

(1) *Deklaratë noteriale nr. rep. ***, datë **.2.2005, nënshkruar nga shtetasit ***. ***. (babai i subjektit) dhe shtetasi ***. ***, ku ky i fundit deklaron se ka marrë nga z. ***. ***. shumën prej 20.000 euro, si këst i parë për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 63 m² (1+1), në katin e parë të banimit, në ***, Kavajë, me vlerë totale 31.500 euro, ndërsa diferenca e çmimit prej 11.500 euro do të paguhej në vijim.*

(2) *Kontratë porosie nr. *** rep./ *** kol., datë **.10.2010, lidhur midis z. ***. ***, me sipërmarrësit ***. ***, e ***. ***, me objekt ndërtimi i një apartamenti (2+1), me sipërfaqe totale 84 m² në katin e parë të banimit, në godinën nr. 1, kundrejt çmimit prej 40.000 euro. Në kontratë përcaktohet se vlera prej 37.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe diferenca 3.000 euro do të shlyhet në momentin e legalizimit të banesës.*

(3) *Deklaratë noteriale nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë **.9.2011, e nënshkruar nga z. ***. ***. dhe sipërmarrësi ***. ***, përmes së cilës babai i subjektit deklaron se, pasi të ketë rregulluar të gjitha marrëdhëniet financiare me investitorin, do të heqë dorë nga e drejta e pronësisë së apartamentit 2+1, duke ia kaluar vajzës, Suela Salavaçi. Gjithashtu, rezervon të drejtën për ndërrim të këtij apartamenti, pasi të ketë shlyer detyrimet financiare të parashikuara në Kontratën e porosisë, datë **.10.2010, duke ia kaluar vajzës, Suela Salavaçi.*

18.6 Komisioni ka kryer analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për mbulimin e pagesave të deklaruara për blerjen e kësaj pasurie, analizë nga e cila është konstatuar se personi tjetër i lidhur/babai i subjektit, ka rezultuar me balancë negative për pagesat e kryera, konkretisht: (i) për pagesën e këstit të parë, në shumën 20.000 euro, në shkurt 2005¹³, me balancë negative për të gjithë këstin në shumën 20.000 euro ose 2.450.800 lekë; (ii) për pagesën e këstit të dytë, në shumën 23.000 euro (17.000 euro këst + 6.000 euro mobilim), në tetor 2010, gjatë hetimit ka rezultuar dhe një kredi e tërhequr *cash* nga nëna e saj, në janar 2010, shumën 2.450.000 lekë në ***, për të cilën subjekti ka deklaruar se mund të ketë shërbyer për pagesën e këtij kësti; (iii) për pagesën e këstit të tretë, në shumën 27.000 euro, në vitin 2012 (25.000 + 2.000), si pagesë e fundit për periudhën janar - maj 2012, me balancë negative në shumën 3.947.630 lekë. Për këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

19. Depozitë dyemërore pranë *-së, në emër të *** ose Suela Salavaçi**

19.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *depozitë në *** dyemërore (***. ***, ose Suela Salavaçi), hapur në datën **.11.2014, në vlerën 65.800 euro, gjendja në datën **.1.2017 është 67.496 USD. Kjo llogari është hapur nga prindërit e mi më datë **.2.2005, në*

¹³ Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë **.2.2005.

*** Bank, me gjendje 52.534 USD...në datën **.12.2012, jam bërë bashkëmbajtëse në këtë llogari dhe nuk kam kontribuar në hapjen e saj. Burimi i krijimit: të ardhura të familjes nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme, të ardhura nga vëllai në Itali etj.

19.2 Në DV- 2004, subjekti ka deklaruar depozitën bankare në shumën 52.000 euro, me pjesë zotëruese 0%, dhe tek seksioni “data dhe viti i krijimit të pasurisë”, subjekti ka deklaruar “në vitin 2003 depozitë në emër të babait, *** ***”.

19.3 Në DV- 2012, tek rubrika e “të dhënave konfidenciale”, subjekti ka deklaruar se është mbajtëse e tretë e një llogarie të *** , me babain dhe nënën.

19.4 Nga të dhënat e *** Bank (ish-***), ka rezultuar se në llogarinë e subjektit Suela Salavaçi, në monedhën USD, është kryer depozitim *cash* i shumës 52.000 USD, në datën **.6.2003, e cila është vendosur në depozitë me afat në datën **.6.2003¹⁴.

19.5 Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj depozite, gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar¹⁵ se: “Referuar dokumentacionit që disponoj, të ardhurat që shërbyen për krijimin e depozitës në shumën 52.534,94 USD, janë të ardhurat familjare që prindërit e mi kishin realizuar deri në atë moment nga qiraja e pasurisë tek *** **, të ardhurat nga puna sezonale në Greqi, të ardhurat sipas Aktmarrëveshjes¹⁶ dhe të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme”.

20. Komisioni kreu analizën e mundësive financiare të prindërve të subjektit për krijimin e depozitës bankare në vitin 2003, nga ku rezultoi pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme për një diferencë negative prej – 5.477.170 lekë, për të cilën i ka kaluar subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

20.1 Lidhur me barrat e provës për të tri pasuritë e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka kundërshtuar analizën e kryer nga Komisioni për burimet e ligjshme të prindërve duke pretenduar, ndër të tjera: (i) shtrirjen e analizës financiare të prindërve vetëm në pasuritë e dhuruara dhe jo investimet e tjera të tyre, si rasti i depozitave bankare; (ii) përfshirjen e pjesës takuese të përfituar nga e ëma prej tezes, ***. ***. (***); (iii) përfshirjen e shumës së përfituar nga aktmarrëveshja e vitit 2003, nënshkruar midis nënës së saj dhe shtetasit ***. ***.

20.2 Komisioni, në përfundim, pasi ka vlerësuar shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti, në mënyrë të përmbledhur, për secilën pasuri, ka arsyetuar:

(1) Për pasurinë nr. 1, apartament banimi në Tiranë¹⁷: [...]Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve për blerjen e apartamentit në Tiranë, në shumën 38.800 USD, dhuruar subjektit në vitin 2013, duke provuar bindshëm mundësitë e tyre financiarë për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2005. Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61,

¹⁴ Në datën **.2.2005, kjo depozitë me shumë 52.534 USD (ku përfshihen dhe interesat) është tërhequr dhe depozituar pranë *** , në llogarinë e depozitës së nënës, ***. ***. Në datën **.9.2011 shtohet si bashkëmbajtës në llogarinë e depozitës ***. ***. dhe më tej, në datën **.11.2012, shtohet bashkëmbajtëse në llogari edhe subjekti Suela Salavaçi, për shumën e depozitës 63.504 USD. Gjendja e depozitës bankare prej 65.864 USD është tërhequr në datën **.11.2014, nga *** Bank, dhe depozituar në të njëjtën datë pranë bankës ***. Më tej, në datën **.11.2016, në llogari janë kredituar interesat e përfituara nga kjo depozitë në shumën 1.696.5 USD, dhe gjendja e llogarisë (depozitë + interes), në datën **.11.2016, paraqitet në vlerën 67.496 USD.

¹⁵ Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën **.11.2022.

¹⁶ Duket se i referohet aktmarrëveshjes së datës **.4.2003, lidhur midis nënës së subjektit dhe z. ***. ***.

¹⁷ Referohuni f. 16-18 të vendimit të arsyetuar.

pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarin e pasaktë të të dhënave [...].

(2) *Për pasurinë nr. 2, Apartament banimi në *** [...] shpjegimet e subjektit lidhur me mundësinë financiare të prindërve për krijimin e kësaj pasurie janë bindëse, duke arritur në përfundimin se iu krijua bindja se prindërit kanë patur mundësi të investojnë në këtë pasuri të paluajtshme dhe se nuk kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

(3) *Për pasurinë nr. 3, Depozitë dyemërore pranë ***-së, në emër të ***. ***. ose Suela Salavaçi [...] (i) kjo depozitë është krijuar para se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit; (ii) subjekti ka deklaruar në DV-në e vitit 2004 depozitën bankare me kontribut 0%, me përshkrimin “Depozitë në emër të babait”; (iii) subjekti e ka provuar këtë fakt edhe përmes deklaratës noteriale datë **.8.2003, sipas së cilës deklaroi se, së bashku me babain, kanë depozituar shumën 52.000 USD, në *** Bank, dega Tiranë. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë faktin që kjo depozitë është krijuar përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit, dhe sa rezultoi nga hetimi administrativ lidhur me të ardhurat e nënës gjatë gjithë jetës së saj nga pasuritë e paluajtshme, në referim të rrethanave, ato nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo në konkluzionin e përgjithshëm mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur [...].*

20.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për sa vijon:

(1) *Lidhur me pretendimin e subjektit mbi shtrirjen e analizës financiare të personave të lidhur/tjerë të lidhur, prindërve, vetëm në masën e pasurive të dhuruara rast pas rasti, pasi, sikundër ka rezultuar, gjithë pasuritë e paluajtshme të prindërve, si dhe pjesërisht pasuritë e luajtshme, janë përfituar nga vetë subjekti i rivlerësimit në formë dhurimi, heqje dorë apo dëshmi trashëgimie.*

(2) *Referuar rastit konkret e rrethanave specifike të krijimit të pasurive, Komisioneri Publik vlerëson se analiza dhe vlerësimi i pasurive do të duhet të bëhet në drejtim të garantimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, duke pasur në konsideratë parashikimet e nenit D pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, për sa kohë investimet e prindërve të subjektit, ndër vite, kanë kaluar po në favor të subjektit të rivlerësimit, në një nga format e përmendura më sipër.*

(3) *Nga ana tjetër, Komisioneri Publik vlerëson, duke mos u kufizuar vetëm në të, se konsiderimi nga ana e Komisionit, në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit, të: (i) të ardhurave të përfituara nga e ëma, nga pjesa takuese e shtetases ***. ***. (***) (tezes), si dhe të (ii) ardhurave të përfituara nga aktmarrëveshja e datës **.4.2003, është i pabazuar dhe jo në përputhje me aktet në dosje, pasi:*

*(i) Lidhur me të ardhurat e pretenduara, të përfituara nga pjesa takuese e shtetases ***. ***. (***), subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi ta ketë deklaruar këtë burim në Deklaratën “Vetting”,*

në deklaratimet periodike vjetore, dhe as në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Përveç sa më sipër, për këto të ardhura, të cilat lidhen ngushtësisht me shtetasen ***, ***, (***) , në cilësinë e trashëgimtares ligjore të shtetasës ***, ***, (***) , subjekti i rivlerësimit nuk provoi posedimin/kalimin e tyre nga trashëgimtarët e tjerë te nëna, duke mbetur kjo e ardhur në nivel deklarativ dhe jo në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, për më tepër.

(ii) Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga aktmarrëveshja e datës **.4.2003, nënshkruar midis nënës së subjektit dhe shtetasit z. ***, ***, nga verifikimi i akteve në dosje, ka rezultuar se dhe shuma prej 15.500.000 lekë, nuk është deklaruar asnjëherë si burim nga subjekti në Deklaratën “Vetting”, në deklaratat periodike vjetore dhe as në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016. Subjekti e ka deklaruar këtë të ardhur vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit.

- Mungesa e dijenisë mbi këtë akt, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, bie në kundërshtim me sa deklaruar nga vetë subjekti mbi burimet e depozitave të krijuara në vitin 2003, nga prindërit¹⁸.

- Kjo aktmarrëveshje duket se është nënshkruar në kushtet e mungesës së titullit të pronësisë nga e ëma e subjektit, nuk provohet ekzekutimi apo arkëtimi nga e ëma e shumës 15.500.000 lekë, si dhe nuk rezultojnë të jetë pasqyruar në ndonjë nga aktmarrëveshjet e mëvonshme, nënshkruar midis bashkëpronarëve për të njëjtën pronë dhe sipërfaqe (përfshirë dhe të ëmën e subjektit) dhe shoqërisë “****”¹⁹.

(4) Për rrjedhojë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, konkluzioni i Komisionit mbi përfshirjen e këtyre shumave në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit, për krijimin e pasurive si më sipër trajtuar, gjendet i pambështetur në akte dhe prova.

(5) Për sa i përket pasurisë nr.2, apartament banimi me adresë ***, Komisioneri Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se, përveç sa më sipër trajtuar mbi mungesën e burimeve të ligjshme për prindërit, deri në fund të vitit 2005²⁰, në konsideratë edhe të kredisë marrë nga e ëma e subjektit, pranë *** Bank, në vitin 2010²¹, për gjithë sa më sipër trajtuar, personi i lidhur/ dhuruesi nuk provoi burimet e ligjshme për pagesën e këstit të tretë të kryer në vitin 2012. Nga analizimi i transaksioneve bankare të prindërve të subjektit, nuk rezultoi ndonjë tërheqje apo transaksion bankar që të lidhet me pagesën e deklaruar.

¹⁸ Subjekti në DV- të vitit 2004 ka deklaruar një depozitë bankare në emër të saj, në shumën 52.543 USD, për të cilën pretendon se kanë burim aktmarrëveshjen e vitit 2003. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit lidhur me mosdijeninë e ekzistencës së kësaj aktmarrëveshje nuk është i besueshëm.

¹⁹ Ashtu sikurse dhe pakica ka arsyetuar në vendimin nr. 703/2023, subjekti nuk provoi se mbi këtë pronë të pretenduar të nënës së subjektit të kishte pasur zhvillim në vitin 2003, me qëllim që të justifikojë ekzekutimi/pagimi i kësaj shume. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti, aktmarrëveshja e datës **.8.2012, në kreun I, “Objekti”, në paragrafin e fundit, citon: “[...] Mbi këtë sipërfaqe ndodhen aktualisht ndërtime të vjetra dhe sipërfaqe truall prej 700 m² për të cilën palët kanë lidhur dhe nënshkruar kontratë, ...për shitje me rezervë të pronës [...]”. Gjithashtu, në deklaratën e lëshuar nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. ***, ***, deklarohet se në këtë pronë janë vënë vetë disa çadra kampingu nga viti 2009. Pra, nuk ekziston ndonjë e dhënë, e cila të provojë se investitori ka zhvilluar pronën nga viti 2003.

²⁰ Ky vit i referohet investimit të prindërve në pasurinë nr.1, depozitat bankare dyemërore dhe pagesave për pasurinë nr. 2, sipas mandateve të vëna në dispozicion.

²¹ Kjo kredi rezultojnë burim i padeklaruar më parë nga subjekti në Deklaratën “Vetting” apo atë periodike, për më tepër që gjatë hetimit ka rezultuar se disa nga këstet për shlyerjen e kësaj kredie janë paguar nga vetë subjekti.

20.4 Sa më sipër trajtuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën mbi burimet e ligjshme të prindërve, duke mos arritur një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurive, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës.

21. Likuiditete cash në shumën 10.000 euro

21.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendje cash në shtëpi, si rezultat i shitjes së pasurisë së paluajtshme, referuar kontratës datë **.8.2012, nr. *** rep., nr. ***/** kol. Vlera 10.000 euro. Pjesa në %: 100%”.

21.2 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Të ardhura nga kontrata nr.***, për shitjen e një prone në emër të nënës time ***. ***, ***. Vlera 14.500 euro. Pjesa në %: 100%”.

21.3 Komisioneri Publik, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite²², vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën *cash*, pasi konstaton se: (1) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën 10,000 euro në DV- 2015, si likuiditet në formën *cash* (*momentin e tërheqjes nga llogaria e saj, të shumës 14,500 euro*); (2) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në DV- 2016 likuiditet në formën *cash*, në shumën 10,000 euro; dhe (3) as në DV-2017 si likuiditet në formën *cash*, apo si dhurim.

21.4 Përveç sa më sipër, deklaratimet e subjektit për shumën 14.500 euro janë kontradiktore, pasi: (i) në përgjigje të pyetjes nr. 4, të Pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se shuma 14.500 euro ka kaluar në llogari të subjektit, por është tërhequr nga kjo e fundit për t’iu dhënë nënës së saj²³, ndërkohë në prapësimet²⁴ lidhur me këtë shumë, subjekti i ka kërkuar Komisionit përfshirjen në analizë financiare të shumës 14.500 euro, përfituar nga kontrata premtim shitje.

21.5 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimi i subjektit për disponimin e likuiditetit *cash* në shumën 10.000 euro, me burim kontratën e shitjes së vitit 2012, mbetet në nivel deklarativ dhe nuk përputhet me aktet në dosje. Deklarimi i subjektit mbi përfshirjen në analizë financiare të shumës prej 14.500 euro, duket se është bërë në funksion të përmbysjes së analizës financiare negative të vitit 2015.

21.6 Për sa më sipër, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasurinë *likuiditet cash*, janë kontradiktore dhe jo bindëse në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

22. Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016

22.1 Komisionit, nga analiza financiare e periudhës 2003-2016, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, i ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme për krijimin

²² Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019, nr. 5/2020, nr. 27/2020.

²³ Subjekti është përgjigjur: “...Shoqëria *** ... për arsye dhe të mosdisponimit të dokumentacionit të plotë të pronës, ka filluar të likuidojë trashëgimtarët. znj. ***. ***. ka qenë punonjëse e shoqërisë dhe është autorizuar, në datën **.4.2015, të kryejë në cash pagesën prej 14,500 euro ...dhurimit të shumës 5,000 euro, nga dy dajat, ku secili i ka dhuruar nënës nga 2,500 euro. Nuk disponoj akt përfaqësimi nga nëna ime për kalimin në llogarinë time të shumës prej 14,500 euro. Kjo shumë ka kaluar në llogarinë time në datën **.04.2015 dhe, po në të njëjtën ditë, kam tërhequr... i kam dorëzuar nënës të gjithë vlerën e tërhequr... u gjykua që pagesa të kalonte në llogarinë time për dokumentimin e saj dhe unë më pas të tërhiqja shumën duke ia dorëzuar nënës”.

²⁴ Referuar dokumentit “Prapësime për rezultatet e hetimit kryesisht...”, f. 9.

e pasurive të luajshme dhe të paluajshme dhe mbulimin e shpenzimeve, në shumën – 6.284.267 lekë, duke i kaluar subjektit barrën e provës, respektivisht për:

(1) *Depozitat në emër të të bijave, pasi:* Nga analiza financiare e kryer, prindërit e subjektit kanë rezultuar me balanca negative në vitin 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016 dhe, për rrjedhojë, duket se nuk kanë pasur mundësi për depozitimet në llogaritë e vajzave të subjektit, depozitë në emër të *** ***, në shumën 11.652 USD, datë 31.12.2016, dhe depozitë në emër të *** ***, në shumën 6.462 USD, datë 31.12.2016.

(2) *Kursimet në cash:* Duket se kursimet e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike vjetore ndër vite, nuk përputhen me gjendjen kumulative të kursimeve nga viti 2007 deri në 2016, të cilat duhet të ishin në vlerën 6.095.925 lekë, nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve.

(3) *Shpenzimet e udhëtimit:* Duket se subjekti ka pranuar dhurata në vlerë totale rreth 8.446 euro, për udhëtimet e kryera gjatë periudhës 2009-2019, të cilat ndikojnë në sjelljen e magjistratit jashtë detyrës; Subjekti nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratimet periodike vjetore, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion që provon ofertat me çmim promocional të përfituara nga agjencia turistike, për udhëtimet e kryera prej saj; Shpenzimet për udhëtimet e kryera në periudhën 2004-2016 u përlllogaritën sipas standardit të Kolegjit, duke u reflektuar në analizën financiare sipas viteve (llogaritur nga Komisioni në vlerën totale 6.311.608 lekë).

(4) *Lidhur me automjetin e blerë në datën *.5.2014²⁵.* Nga analiza financiare për blerjen e automjetit duket se ka rezultuar një balancë negative në shumën 620.459 lekë, deri në momentin e blerjes së automjetit, referuar rezultateve paraprake të hetimit²⁶.

22.2 Komisioni, pasi ka vlerësuar shpjegimet e subjektit, respektivisht për sa më sipër, në përfundim, ka arsyetuar se:

(1) Për sa i përket burimit të ligjshëm të prindërve për krijimin e depozitave bankare në emër të vajzave: [...] Komisioni analizoi mundësinë e prindërve dhe, referuar analizës kumulative të prindërve për periudhën 2004 – 2016, pas prapësimeve, ka rezultuar me balanca pozitive, pasi u morën në konsideratë të ardhurat që rrjedhin nga pasuritë trashëgimore të nënës, sa më sipër trajtuar. Komisioni e vlerëson të drejtë pretendimin e subjektit, pasi, përmes dokumentacionit të paraqitur, ka provuar të ardhurat e ligjshme të nënës, si dhe dhurimin e kryer nga vëllai i saj [...].

(2) Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi kursimet në cash: [...] në analizë të prapësimeve të subjektit lidhur me gjendjen e kursimeve cash, Komisioni çmoi të konsiderojë pretendimet e subjektit, si dhe deklaratimet në seancë, duke e rishikuar analizën financiare, duke i konsideruar si gjendje likuiditetesh në fund të vitit [...].

(3) Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi shpenzimet e udhëtimit: [...] pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në prapësime, ka vlerësuar t'i konsiderojë

²⁵ Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Automjet me targë ***, blerë sipas kontratës së shitjes me Landeslease, datë *.05.2014, në shumën 6.690 euro. Burim krijimi: Nga të ardhurat familjare. Vlera 6.690 euro. Pjesa në %: 100%”.

²⁶ Komisioni, përveç pamjaftueshmërisë financiare, i ka kaluar barrë prove dhe pasi: (i) Duket i paqartë çmimi i blerjes së automjetit në vlerën 6,690 euro, e cila përfaqëson vlerën e mbetur të detyrimit financiar të shtetases ***, ***. për këtë automjet.

pretendimet e subjektit, duke rishikuar analizën financiare lidhur me shpenzimet e udhëtimit²⁷. Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, rrethanat e konstatuara nuk përbëjnë arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe nuk kanë afektuar deklarimin në Deklaratën Vetting të vitit 2017[...].

(4) Për sa i përket blerjes së automjetit në vitin 2014: [...] Komisioni i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit, pasi nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe qiramarrëses ***. ***. dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ngrejë dyshime lidhur me ndonjë trajtim preferencial në çmimin e blerjes së automjetit. Për sa i përket balancës negative, Komisioni ka reflektuar në analizë financiare gjendjet e kursimeve cash të saktësuara nga subjekti. Për rrjedhojë, analiza financiare për vitin 2014 pas prapësimeve ka rezultuar me balancë pozitive [...].

22.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa në vijim:

22.3.1 Për sa i përket pretendimeve të subjektit, për burimet e ligjshme të prindërve për krijimin e depozitave në emër të të bijave, Komisioneri Publik sjell edhe njëherë në vëmendje se, nisur nga pamjaftueshmëria financiare e akumuluar ndër vite, e konstatuar për prindërit e subjektit, për sa argumentuar gjerësisht më sipër, në pasuritë *apartment* dhe *depozitë bankare*, subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme të prindërve për mbulimin e shpenzimeve, investimeve dhe shumave të deklaruara të dhuruara ndër vite, me qëllim krijimin e depozitave në emër të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit, vajzat. Prapësimet e subjektit mbi këtë barrë prove mbështeten kryesisht në përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të prindërve, të ardhurave nga pjesa takuese e tezes së nënës, shtetases ***. ***. (***)., si dhe nga aktmarrëveshja e datës **.4.2003, trajtuar gjerësisht më sipër.

(i) Për sa i përket pretendimeve të subjektit për të ardhurat e përfituara nga e ëma, nga qiradhënia e pasurisë *apartment* në rrugën “****. ****.”, pasuria nr.1 (vitet 2006 e vijim), në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk u provua ligjshmëria e tyre dhe pagesa e detyrimeve tatimore në kuadër të parashikimit të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

22.3.2 Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi *posedimin e kursimeve cash* ndër vite, në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, pretendimet e subjektit gjenden të pabazuara, pasi:

(i) Referuar ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, formulari nr. 3 i Deklaratës periodike vjetore, në mënyrë të qartë, kërkon deklarimin e ndryshimeve të interesave privatë në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ku kërkohen të përshkruhen *hollësisht ndryshimet në llojin, sipërfaqen, adresën, vlerën në lekë apo valutë ...pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie,*

²⁷ Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se, për sa i përket udhëtimeve, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi, pasi nuk ka deklaruar në deklarimet periodike dhe në Deklaratën “Vetting” mbulimin e këtyre shpenzimeve, por u provua se ato nuk janë kryer për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, ndaj dhe nuk duhet të ndikojnë në analizën e përgjithshme financiare të subjektit të rivlerësimit apo në konkluzionin e përgjithshëm, mbi pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur. Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si parakusht për përgjegjësinë disiplinore, për efekt të këtij procesi, që pasaktësitë, si premisë për shkarkim, të jenë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave.

të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Bazuar dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, kursimet *cash*, për nga vetë natyra e tyre, duhet të llogariten dhe analizohen ashtu sikundër deklaruar nga subjektet në deklaratat periodike vjetore.

(ii) Nga leximi i deklaratave periodike vjetore, depozituar nga subjekti në ILDKPKI, të cilat, për qëllime të këtij procesi, konsiderohen provë bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit 84/2016, rezulton se subjekti, në rubrikën ku kërkohet të deklarohen ndryshimet, shtesa apo pakësime të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, duke filluar që nga viti 2007, ka deklaruar kursime në shuma të ndryshme, referuar si "*kursime nga pagat*". Në asnjë nga deklaratimet periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të tyre.

(iii) Lidhur me pretendimin e subjektit se, për vitin 2007,²⁸ shuma e deklaruar e kursimeve prej 400.000 lekë, i referohet shumës së depozituar në llogarinë bankare pranë *** BANK, vlerësohet se kjo shumë nuk duket të jetë e njëjta me shumën e depozituar në llogarinë e saj bankare pranë *** BANK prej 3.996 USD, pasi, përveçse nuk korrespondon si vlerë, sjellim në vëmendje që subjekti, në deklaratimet e mëparshme periodike vjetore, ka deklaruar saktësisht posedimin e depozitave bankare në emër të saj apo personave të lidhur me të, duke specifikuar dhe vendndodhjen e tyre (sikundër ka bërë në DV-2004 - 2005).

(iv) Ndërkohë, në deklaratat periodike vjetore 2008 e në vijim, rezulton se subjekti ka deklaruar në rubrikën ku kërkohet të deklarohen ndryshimet, shtesat apo pakësimet në pasuri, përfshirë dhe pasuritë likuiditete *cash*, në të njëjtën mënyrë kursimet, duke iu referuar si "*kursime nga paga*". Në përgjigje të rezultateve të hetimit, për këto deklarime, subjekti ka pretenduar se iu referohet deklarimeve *gjendje* në momentin e plotësimit të deklaratës respektive periodike vjetore.

(i) Si rrjedhim, në vlerësim të Komisionerit Publik, mbetet i pambështetur konkluzioni i Komisionit për konsiderimin e kursimeve *cash* sipas pretendimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit, herë si kursime në depozitë bankare dhe herë si *gjendje* në fund të vitit dhe jo shtesë e vitit. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe pretendimet e saj mbi disponimin e kursimeve në *cash* ndër vite, ndryshe nga sa deklaruar në deklaratat periodike vjetore, mbetën në nivel deklarativ. Pretendimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës janë në kundërshtim dhe me shpjegimet e dhëna nga vetë subjekti në ILDKPKI, në korrik të vitit 2016, mbi posedimin e kursimeve në *cash*.²⁹

22.3.3 Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi reduktimin e *shpenzimeve të udhëtimit*, rezulton se Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit, duke reduktuar shpenzimet e udhëtimit nga vlera 6.311.608 (*gjashtë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetë*) lekë, e llogaritur fillimisht në vlerën 4.581.302 (*katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e dy*) lekë, me një pakësim prej rreth 1.700.000 (*një milion e*

²⁸ Mbi kursimet në *cash*, subjekti, në mënyrë të përmbledhur, ka kundërshtuar llogaritjet e kryera nga Komisioni, duke konsideruar si shtesa nga të ardhurat vjetore çdo shumë të deklaruar në deklaratat respektive, pasi në disa raste, ajo (subjekti) me kursimet e deklaruara në DV përkatëse, i është referuar kursimeve të depozituara në llogaritë bankare (për shembull, deklarimi i kursimeve të vitit 2007). Për me tepër referohuni prapësimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

²⁹ Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: [...] sa i përket deklarimeve të saj në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, se *gjendja cash*, në fund të vitit 2014, ka qenë 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro, ky deklarim është lapsus dhe vjen nga përllogaritja e gabuar e *gjendjes*, duke u kthyer prapa në kohë [...].

shtatëqind mijë) lekë. Nga verifikimi i llogaritjeve, konstatohet se ky reduktim vjen kryesisht³⁰ si rezultat i marrjes në konsideratë të pretendimeve të subjektit mbi mbulimin e shpenzimeve nga shoqëria “*** **” apo të tjerë.

(i) Komisioneri Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se ky konkluzion i Komisionit nuk gjen mbështetje as në provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe as në metodologjinë apo standardin e vendosur nga Kolegji në vendimin (JR) nr.11/2019, të aplikuar për subjektet e tjera në proces rivlerësimi³¹.

(ii) Nga analiza e akteve dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se subjekti ka pretenduar se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve të udhëtimit janë mbuluar nga administratorët e kompanisë “*** **” sh.p.k., duke mos i konsideruar si dhurata³², por shpenzime të mbuluara nga miqtë e familjes.

(iii) Ndërkohë, referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2020, të znj. ***, ***, administratore e shoqërisë “*** **”, ndër të tjera, deklararon se udhëtimet kanë qenë *dhuratë* për shkak të miqësisë së ngushtë. Gjithashtu, referuar vetë përgjigjeve të subjektit në pyetësin standard të Komisionit, konstatohet se janë deklaruar udhëtime të mbuluara tërësisht nga persona të tretë në formë dhurate, si: “Udhëtim në Romë, në datat **.**.1.2014, *dhuratë* nga ***, ***, në vlerën 350 euro”, “Udhëtim i datave **.9.2008 - **.9.2008, pushime familjare në Antalia, *dhuratë nga hoteli*”³³.

(iv) Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratimet periodike vjetore mbulimin e këtyre shpenzimeve, as në formën e dhurimeve, as në formën e trajtimeve preferenciale, përkundrejt detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe as në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016, pyetur pikërisht për kostot e udhëtimit.

(v) Këto pretendime të subjektit, të padeklaruara në deklaratimet periodike vjetore, si dhe të pashoqëruara me akte shkresore provuese të kohës, por vetëm me deklaratimet noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, për vlerën e të cilave Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar³⁴, merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit.

³⁰ Përjashtim bëjnë disa raste, kur subjekti i rivlerësimit pas prapësimeve ka provuar me dokumentacion se kostot janë mbuluar nga punëdhënësi (në rastin e udhëtimeve të bashkëshortit).

³¹ Komisioneri Publik sjell në vëmendje se dhe rastet e parashikuara në metodologjinë e përdorur deri më tani nga ana e Kolegjit, për shpenzimet e mbuluara nga të tretë, ky i fundit, Kolegji, orienton Komisionin të rillojarisë me vlerën 5 euro/dita vetëm kostot e qëndrimit në rast akomodimi të personat, pala pritëse, që provojnë rezidencën e tyre në shtetin ku subjektet kanë udhëtuar dhe në asnjë rast mbulimin e plotë të shpenzimeve, nëse nga subjektet nuk provohet e kundërta me dokumente justifikuese.

³² Referuar prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, f. 33, prg. 3.

³³ Gjithashtu, referuar deklaratës noteriale të datës **.2.2020, të shtetasit ***, ***, ku deklarohet se znj. Suela Salavaci është vajza e hallës se tij dhe, nga data **.11.2005 – **.1.2006, ka qëndruar në banesën e tij, pa asnjë lloj shpenzimi. Konstatojmë se gjatë periudhës së qëndrimit në SHBA, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në jetë fëmijën e saj të dytë, me datëlindje **.12.2005 dhe vendlindje ***, SHBA, shpenzime të cilat nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit as në deklaratimin vjetor, por as gjatë hetimit administrativ.

³⁴ Shih vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***, nr. 7/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 34/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***, nr. 2/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 23/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***, nr. 24/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 29/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 33/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 11/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 12/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit ***, ***, nr. 11/2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***.

22.3.3.1 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi mbulimin e kostove të udhëtimeve për periudhën 2003-2016.

(1) Për sa i përket pretendimeve të subjektit mbi pamjaftueshmërinë financiare për blerjen e automjetit në datën **.5.2014, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës. Në prapësimet e saj, në funksion të blerjes së këtij automjeti, subjekti referon deklarin në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën **.7.2016, se në vitin 2014 ka pasur gjendje *cash* 1.000.000 lekë dhe 5.000 euro, në dispozicion për blerjen e automjetit, në kundërshtim me sa ka pretenduar në funksion të prapësimeve mbi likuiditetin në formën *cash* të vitit 2014, sa më lart trajtuar (konsideruar lapsus). Subjekti i rivlerësimit, në DV-2014, nuk ka deklaruar pakësim të likuiditetit *cash*, si burim për blerjen e automjetit.

22.4 Në përfundim, në përmbledhje të sa më sipër trajtuar, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të saj dhe personave të lidhur me të për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve ndër vite për periudhën 2003 - 2016. Kjo pamjaftueshmëri, e parë dhe në harmoni dhe me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të, prindërit, e vendos subjektin e rivlerësimit përpara parashikimeve të pikës 3, të neni 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arrin një nivel të besueshëm në kontrollin e kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës.

IV.B. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

23. Rezulton se hetimi i Komisionit, lidhur me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është bazuar në administrimin e të gjitha burimeve të vlerësimit, verifikimin dhe analizimin e tyre, ndër të tjera, dhe: (i) *Raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, hartuar nga KLP*; si dhe (ii) *Denoncimeve nga publiku*.

24. Bazuar në burimet e mësipërme rezulton se, nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, për subjektin e rivlerësimit kanë rezultuar *gjithsej 16 ankesa*, ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit, pranë Komisionit, janë depozituar në total *18 denoncime*³⁵. Komisioni, pas analizimit të gjetjeve mbi disa procedime penale, si dhe denoncimeve nga publiku, të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për disa prej tyre, ka vlerësuar se ato, në tërësi, nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

24.1 Në përfundim, lidhur me këtë kriter, sipas shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar e aftë profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, por në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur që të referojë pranë organit kompetent ILD, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi, lidhur me kallëzimin e *regjistruar nr. ***, viti 2014*, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

³⁵ Komisioni referon se janë administruar gjithsej 31 denoncime nga publiku, disa prej të cilave janë të përsëritura.

25. Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, në analizë të çështjeve të trajtuara nga Komisioni, ndan qëndrim të ndryshëm lidhur me transferimin pranë organit kompetent të juridiksionit të zakonshëm disiplinor, ILD-së, të kallëzimit penal të regjistruar me nr. ***, i vitit 2014, pasi, referuar parashikimit të nenit 117, të ligjit nr. 96/2016, është jashtë afatit 5-vjeçar nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar. Komisioneri Publik, ashtu sikurse dhe Kolegji ka orientuar në jurisprudencën e tij, vlerëson se gjetjet e këtij rasti duhen vlerësuar nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj.³⁶

26. Sa më sipër, Komisioneri Publik, në analizë të vendimit nr. 703/2023, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Salavaçi, vlerëson se nga të dhënat e administruara nga burimet e vlerësimit të aftësive profesionale, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për sa do të trajtohen në vijim:

27. Gjetje e përfaqësuesit ndërkombëtar, lidhur me dosjen penale nr. * të vitit 2010**

27.1 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM), me shkresën nr. prot. 398, datë 27.6.2023, ka paraqitur në Komision, materialin *Gjetje*, ku referohet vlerësimi dhe analizimi i kryerjes së veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, në dosjen penale me nr. ***, viti 2010, të kallëzuesit ***. ***. Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar, në zbatim të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë në këtë proces.

27.2 Po ashtu nga aktet në fashikull, rezulton se kjo çështje është pjesë dhe e *Raportit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit*, në rubrikën: *Të dhëna arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime*, si praktika me nr.*** e vitit 2012, regjistruar pas ankesës së shtetasit ***. ***, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj subjektit të rivlerësimit. Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr.***/** prot., datë **.2.2012, ka bërë me dije ankuesin se vendimi i pushimit, *pasi është ankimuar, është kthyer për hetime të mëtejshme nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe organi i Prokurorisë ka rifilluar hetimet e këtij procedimi dhe po kryhen veprimet e duhura dhe të mundshme hetimore.*

27.3 Nga aktet e përcjella nga ONM, për rastin konkret, Komisionit i ka rezultuar se:

(1) *Rrethanat e faktit.* Shtetasi ***. ***, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me një kallëzim të regjistruar me nr. ***, datë **.7.2010, mbi bazën e të cilit, organi i akuzës, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar dhe ka filluar procedimin penal nr. ***, datë **.7.2010, për veprën penale të "*Falsifikimit të dokumenteve*", të parashikuar nga neni 186 i K. Penal.

(2) Objekti i kallëzimit konsiston në një kontratë qiraje, datë **.12.2004, të nënshkruar midis kallëzuesit, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës Shëndetësore, për mbrojtjen e individit "**** ***", *me administratoren e shoqërisë "**** ***.***" sh.p.k., shtetasen ****. ****.*, para noteres ***. ***, për dhënien me qira të një objekti në Tiranë, me qira mujore 200

³⁶ Referohuni vendimit (JR) nr. 2/2020, prg. 32.5, të Kolegjit të Posaqëm të Apelit.

USD. Ankuesi pretendon se nga ana e të kallëzuarës është falsifikuar kjo kontratë dhe, në një proces gjyqësor civil që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, është paraqitur një kontratë, sipas së cilës vlera e qirasë ka qenë 900 USD në muaj.

(3) Subjekti i rivlerësimit, pasi ka kryer disa veprime hetimore procedurale³⁷, me vendimin e datës **.2.2011, ka vendosur *pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. *** të vitit 2010*, pasi ka konstatuar se: (1) Kontrata nr.*** rep./*** kol., datë **.12.2004, para noterës ***. ***, është një dokument i falsifikuar; (2) *shtetasja ***.***. e ka përdorur këtë dokument në procesin civil që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë*; (3) noterja ***. ***. ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin.

(4) Nga aktet rezulton se nga subjekti i rivlerësimit është *përcaktuar dokumenti i falsifikuar, personi që e ka përdorur, personi që e ka falsifikuar, koha dhe vendi i përdorimit, si dhe mekanizmi i falsifikimit, por organi i Prokurorisë ka vendosur pushimin e hetimeve, duke i dhënë faktit cilësimin juridik të shpërdorimit të detyrës dhe duke pretenduar parashkrimin e ndjekjes penale sipas nenit 66 të K. Penal.*

(5) Vendimi i pushimit është ankimuar nga shtetasi ***. ***, i cili, ndër të tjera, së bashku me shfuqizimin e vendimit të pushimit, ka kërkuar dhe kryerjen e dy veprimeve të tjera hetimore.

(6) Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. regj. them. ***, datë **.5.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shtetasit ***. ***, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes, duke arsyetuar, ndër të tjera, se *veprimet hetimore që kërkohen për t'u kryer nuk sjellin asnjë element të ri lidhur me faktet objekt gjykimi, pasi organi i Prokurorisë ka pranuar ekzistencën e falsifikimit të kontratës (pra faktit kriminal), por i ka dhënë këtij fakti një vlerësim të ndryshëm juridik*. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi ***. ***, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

(7) Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.***, datë **.11.2011, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe vendimit të pushimit të organit të Prokurorisë, si dhe dërgimin e çështjes për hetime të mëtejshme (e cila konsiston në marrjen e kontratës noteriale pranë organit tatimor). Gjykata e Apelit ka arsyetuar se *organi i Prokurorisë është i detyruar që të kryejë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme nga ana e saj dhe ato të kërkuara nga kallëzuesi dhe, në përfundim të tyre, është në kompetencën e saj të konkludojë në lidhje me ushtrimin ose jo të ndjekjes penale.*

(8) Nga shënimet në vendimin e Gjykatës rezulton se kundër këtij vendimi është ushtruar dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë **.6.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit nga Prokurori i Apelit Tiranë.

(9) Më tej, çështja penale i është caktuar në nëntor të vitit 2011, për hetime të mëtejshme, një prokurori tjetër, z. ***. ***, i cili, pas zbatimit të detyrave të caktuara nga Gjykata e Apelit

³⁷ Referuar vendimit nr. *** regj. them., datë **.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, bashkëlidhur *Gjetjes*, rezulton se janë marrë në cilësinë e provës kontratat noteriale të qirasë, të redaktuara nga noteri ***. ***. (të pretenduar si të falsifikuar), si dhe është kryer akti i ekspertimit në datën **.2.2011, ku është konkluduar se në këtë akt ka ndryshime midis tri fletëve të para dhe fletës së katërt, ku kjo e fundit ka ndryshime teknike dhe grafike, krahasuar me tri fletët e para dhe nënshkrimi i shtetasit ***. ***. nuk është nënshkruar nga i njëjti person që ka nënshkruar në tri fletët e para. Pra, faqja e katërt e kontratës nuk është pjesë origjinale e saj.

Tiranë, duke arsyetuar, ndër të tjera, se [...] *notere, shtetase ***. ***, ka konsumuar elementet e veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal, pasi me veprimet e saj e ka bërë të vlefshëm këtë dokument të falsifikuar. Bazuar në nenin 66/c të K. Penal, kjo vepër është parashkruar [...] Prokurori i çështjes ka vendosur: (1) të pushojë procedimin penal nr. *** të vitit 2010; (2) të deklarohej e falsifikuar kontrata nr. *** rep./*** kol., datë **.12.2004, dhe të bëhet asgjësimi i saj nga Policia Gjyqësore.*

27.4 Komisioni, në rezultatet e hetimit, lidhur me këtë çështje, nuk i ka kërkuar shpjegime subjektit, por ka arsyetuar se nga verifikimi i dosjes penale³⁸, duket se Gjykata e Apelit Tiranë ka kërkuar nga organi i akuzës kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, të cilat, edhe nëse do të administroheshin nga organi i Prokurorisë, nuk do të ndryshonin ecurinë e çështjes penale. *Duket se vlerësimi i fakteve dhe i provave të çështjes është kryer bazuar në bindjen e brendshme të prokurorit.*

27.5 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa konkluduar Komisioni, vlerëson se në analizë të rastit të paraqitur me *Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar*, e cila përbën provë në këtë proces, dhe në gjendjen që janë aktet në dosje, rezultojnë disa rrethana që duket se afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pika 2 dhe 3, si dhe nenit 75, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, të cilat janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

(1) Referuar rastit konkret, Komisioneri Publik vlerëson se mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore shtesë, nuk është pa ndikim në ecurinë e kësaj çështje penale, si në aspektin procedural kohor, ashtu dhe në aspektin material të së drejtës së kallëzuesit, për sa kohë dokumenti që pretendohet se ishte falsifikuar duket se po përdorej në atë moment *nga shtetasja ***.***, në një proces tjetër gjyqësor civil dhe po ky akt ishte depozituar dhe pranë organeve tatimore.*

(2) Po ashtu Komisioni, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhet të kishte analizuar në mënyrë më të detajuar dhe cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit, mbi ndryshimin e cilësimit juridik të veprës së kallëzuar nga *falsifikim i dokumenteve kundrejt shtetasës ***.****, për të cilën ishte regjistruar kallëzimi, në *shpërdorim detyrë*, për noteren, shtetasen ***.***, në momentin e vendimit të pushimit të saj, parë kjo në drejtim të përgjegjësisë së personave të përfshirë në këtë vepër, rrethanat kohore kur këta persona e kanë përdorur këtë dokument, në raport dhe me efektin procedural të parashkrimit të këtyre veprave penale.

(3) Ndër të tjera, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se *shtetasja ***.***, administratore e shoqërisë “**** **”, ndaj së cilës është bërë kallëzimi për falsifikim dokumentesh, në janar të vitit 2010, ka lidhur kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme³⁹, me personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit, të emën e saj, dhe titullarët e*

³⁸ Aktet bashkëlidhur Gjetjes së ONM-së.

³⁹ Kontrata nr. *** rep./*** kol., datë **.1.2010. Referuar përgjigjes së *** Bank ndaj kërkesës së subjektit të rivlerësimit, rezulton se pagesat për këtë kontratë janë bërë me çek bankar, nga shoqëria “**** **”, ku shtetasja ***.*** është administratore.

tjerë të pasurisë, me objekt shitjen e truallit me sipërfaqe 640 m², në një vlerë totale prej 502.500 euro, të ardhurat e të cilës janë deklaruar nga subjekti si burim për krijimin e pasurive të saj.

28. *Denoncim i shtetases* *** ** 40

28.1 Kjo shtetase ankohet për subjektin e rivlerësimit Suela Salavaçi, me pretendimin se është në marrëdhënie direkte me personat e kallëzuar nga ana e saj për dhunim banese, vjedhje me anë të mashtrimit dhe falsifikim dokumentesh, kallëzim për të cilin subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit. Sipas denoncueses, procedimi penal është mbajtur pa regjistruar 1 vit e 2 muaj, pastaj është vendosur mosfillimi. Denoncuesja shprehet se subjekti i rivlerësimit është në kontakt të vazhdueshëm me persona të kallëzuar dhe persona me precedentë penal, si ***, ***, ***, ***, ***, ***, etj.

28.2 Kjo çështje është publikuar dhe në median *online*⁴¹, ku ndër të tjera citohet se i pandehuri ***, ***, me veprime konkrete, ka falsifikuar nënshkrimin e bashkëshortes së tij/denoncueses ***, ***, në prokurën me anë të së cilës autorizonte të pandehurën ***, ***, për të shitur një banesë dykatëshe. Bashkëshorti i denoncueses ka falsifikuar një prokurë të dërguar nga Republika Domenikane, ndërkohë që shtetasja ***, ***, ka rezultuar se nuk ka shkelur më parë në këtë shtet.

28.3 *Rrethanat e faktit*. Referuar akteve të paraqitura nga denoncuesja ***, ***, çështja penale konsiston në një kallëzim të kryer prej saj ndaj shtetasve ***, ***, dhe ***, ***, për veprat penale të “*Dhunimit të banesës*” dhe “*Falsifikimit të dokumenteve*”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 112 i K. Penal, regjistruar si *procedimi me nr.***, datë **.7.2019*, hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

(1) Kallëzuesja ka pretenduar se është pronare e ligjshme e banesës 2-katëshe në Tiranë, të cilën e kishte blerë në vitin 1996 dhe ka banuar e qetë në banesën e saj deri në momentin kur është vënë në dijeni të një kontrate noteriale shitblerje, të nënshkruar në datën **.2.2006, ku banesa i është shitur shtetasit ***, ***. Ky i fundit, gjithashtu, e ka shitur pronën me kontratën e shitjes datë **.5.2012, te shtetasi ***, ***, i cili, përmes zyrës përmbarimore, e ka nxjerrë kallëzuesen nga banesa, megjithëse kishte dijeni se kontrata e shitjes ishte fiktive, duke ia dhënë pronën me qira shtetasit ***, ***. Gjithashtu, shtetasi ***, ***, në vitin 2018, kishte lidhur kontratën për energjinë e elektrike me OSHEE-në.

(2) Sipas denoncueses, kontrata e shitjes, datë **.2.2006, është konstatuar absolutisht e pavlefshme me vendim gjyqësor datë **.5.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për shkak të përdorimit të një prokure të falsifikuar në emrin e saj si shitëse, e përdorur nga bashkëshorti i saj.

(3) Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të veprimeve hetimore, në datën **.11.2019, ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes penale, me argumentin se faktet e provuara nga hetimi nuk parashikohen nga ligji si vepër penale.

(4) Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin e datës **.1.2020, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, datë **.7.2019, dhe vazhdimin e mëtejshëm të

⁴⁰ Denoncimi me nr. prot. ***, datë **.4.2021.

⁴¹ <http://www.panorama.com.al/mashtrimi-ish-bosi-i-piramides-populli-denohe-8-muaj-burg/>

hetimeve. Në vendimin gjyqësor, ndër të tjera, arsyetohet se: [...] Nga të dhënat e hetimeve paraprake rezulton se nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me faktin e përdorimit të dokumentit të falsifikuar kontratë shitje...datë **.5.2012, si dhe fshirja nga regjistri i ZVRPP në Tiranë...Gjykata çmon se hetimet nuk janë zhvilluar të plota konkretisht lidhur me veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i K. Penal, në formën e përdorimit të dokumentit të falsifikuar nga shtetasi ***, ***, Dhe, për këtë shkak, hetimet duhen orientuar në këtë drejtim [...].⁴²

28.4 Sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime bazuar në dokumentacion mbështetës, lidhur me pretendimet e denoncueses për mosregjistrim të procedimit dhe kthimin e akteve nga Gjykata për hetim të paplotë.

28.5 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se regjistrimi i procedimit penal, i cili mban numrin ***, është regjistruar vetëm 4 ditë pas regjistrimit dhe shortimit manual të tij. Subjekti sqaron se lidhur me këtë material kallëzues është kërkuar pushimi i procedimit dhe jo mosfillimi i hetimeve. Ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për kthimin e akteve prokurorit, është ushtruar apel dhe kjo çështje, për të cilën është caktuar relatori, nuk është planifikuar për gjykim. Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar dhe dokumentacionin përkatës⁴³.

28.6 Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka dhënë shpjegime mbi arsyet e kthimit të akteve nga Gjykata dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, por ka informuar lidhur me faktin se kjo çështje është ende në shqyrtim nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë. Sa i përket regjistrimit të materialit kallëzues, Komisioni ka konstatuar se subjekti arriti të provojë përmes akteve se regjistrimi i procedimit penal është kryer brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

28.7 Komisioneri Publik konstaton se, dhe në rastin konkret, subjekti nuk dha shpjegime bindëse mbi *mungesën e veprimeve hetimore dhe drejtimin e duhur të tyre*, konfirmuar kjo edhe nga kontrolli gjyqësor. Nga aktet rezulton se çështja është në Gjykatën e Apelit, si rezultat i ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit/organi i akuzës, por nga ana procedurale, në rrethanat konkrete, për efekt të nenit E/2 të aneksit të Kushtetutës, subjekti ka mbaruar shqyrtimin e kallëzimit të analizuar, në momentin që ai, pasi ka kryer veprimet hetimore, që ka vlerësuar të nevojshme, është shprehur me vendimin për pushimin e procedimit penal, vendim i cili, proceduralisht me ndryshimet e K. Pr. Penale, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor⁴⁴.

28.8 Problematikat e konstatuara, në rastin konkret, janë të vlefshme për t’u trajtuar nga Kolegji, sipas kriterëve të vlerësimit të ligjit nr. 96/2016, eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

⁴² Nga të dhënat e hetimeve paraprake nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me faktin e përdorimit nga shtetasi ***, ***, të dokumentit të falsifikuar kontratë shitje, datë **.5.2012 (akt i cili është deklaruar i pavlefshëm me vendim gjyqësor), si dhe lidhja e kontratës së energjisë elektrike me OSHEE-në, në datën **.11.2019, nga ky shtetas. Gjithashtu, Gjykata orienton organin procedues për sekuestrimin e praktikës së aplikimit të kryer pranë OSHEE-së, si dhe të merret në cilësinë e provës kopje e fashikullit lidhur me mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë **.3.2017, të kallëzueses ***, ***, (pasi kjo shtetase ka kryer më herët kallëzime të tjera).

⁴³ Formularin për trajtimin e materialit kallëzues nr. ***, datë **.6.2019; urdhrin e regjistrimit të procedimit penal, datë **.7.2019; kallëzimin e shtetases ***, ***, datë **.6.2019; shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë **.2.2020, së bashku me ankimin; shkresën nr. *** prot., datë **.9.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

⁴⁴ Neni 329/a i K. Pr. Penale, shtuar me ligjin nr. 35, datë 30.3.2017.

29. Denoncim i shtetasve ***, ***, **, ***, (***) dhe ***, ***, (***)⁴⁵

29.1 Në denoncimin e tyre, shtetasit ankohen për veprime joprofesionale të organit të akuzës, lidhur me kallëzimin penal me nr. ***/2014, të bërë nga ato në cilësinë e pronarëve, ndër të tjera, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës në ushtrim të funksionit publik, shkatërrimit dhe shpërdorimit të pronës, ndaj punonjësve të administratës qendrore dhe vendore. Denoncuesit pretendojnë se vendimi i pushimit është shfuqizuar tri herë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe se nuk janë njoftuar, thirrur në cilësinë e kallëzuesve për ndonjë vendimmarrje të mundshme nga ana e Prokurorisë.

29.2 Po ashtu, nga aktet në fashikull, rezulton se kjo çështje është pjesë dhe e *Raportit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit*, në rubrikën: *Të dhëna arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime*, si praktika me nr. ***, vitit 2018. Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. ***/** prot., datë **.5.2018, ka informuar ankuesin se me ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.76/2016 dhe ligjin nr. 97/2016, Prokurori i Përgjithshëm nuk e ka më si kompetencë kontrollin e veprimtarisë hetimore të kryer nga ana e prokurorëve, ndaj, për çdo pretendim lidhur me vendimmarrjen e tyre, duhet t'i drejtohen gjykatave.

29.3 *Rrethanat e faktit*. Bashkëpronarët e familjes ***, më datë **.11.2013, kanë kryer një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ndaj punonjësve të Bashkisë Tiranë, konkretisht administratorit të përgjithshëm të Bashkisë Tiranë dhe subjekteve private “****” L.t.d. dhe “****” sh.p.k., për veprën penale të “*Falsifikimi i dokumenteve*”, “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe “*Shkatërrimit të pronës*”, parashikuar nga nenet 25, 150, 186, 248 të K. Penal.

(1) Shtetasit në kallëzimin e tyre pretendojnë se, me vendim të AKKP⁴⁶-së, iu është kthyer një sipërfaqe toke truall i lirë, prej 14.410 m², në zonën e ish-Kinostudios. Më datë **.10.2013, kallëzuesit kanë vënë re se mbi sipërfaqen e pronës së kthyer fizikisht kishin filluar gërmimet nga subjektet, më pas të identifikuar si “****” L.t.d. dhe “****” sh.p.k., të cilët po kryenin ndërtime në bazë të një kontrate sipërmarrje nr. ***/**, datë **.5.2013, të lidhur me Bashkinë Tiranë, me objekt: “*Rikualifikim urban i qendrës së Kinostudios, Sheshi Kinostudio dhe Blloku 91*”⁴⁷.

29.4 Procedimi penal është regjistruar në datën **.2.2014, për veprën penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe është ndjekur nga dy prokurorë të tjerë, deri në datën **.9.2015, kur dosja hetimore i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.

29.5 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.10.2015, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2014, ndër të tjera, duke arsyetuar se: *veprimet /mosveprimet e punonjësve të Bashkisë së Tiranës nuk përbëjnë elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.*

⁴⁵ Denoncimi me nr. *** prot., datë **.10.2019 dhe aktet bashkëlidhur.

⁴⁶ Vendimi nr. ***, datë **.8.2013.

⁴⁷ Denoncuesit pretendojnë se punimet po kryhen në pronën e tyre, kthyer me vendim të AKKP-së, jashtë projektit, si dhe Bashkia Tiranë, në datën **.6.2013, i ka kthyer përgjigje AKKP-së Tiranë, se pikërisht në këtë zonë nuk ka studim urbanistik të miratuar në KRRT Bashkia Tiranë dhe gjithashtu në vijim sqaron se kjo pronë nuk është në inventarin e pasurive të paluajtshme të Bashkisë. Sipas kallëzuesve, në bazë të këtij informacioni, AKKP Tiranë u ka kthyer tokën bashkëpronarëve të familjes ***.

29.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë **.4.2016, ka vendosur *shfuqizimin e vendimit për pushimin e hetimeve të procedimit penal ****, datë **.10.2015, duke vlerësuar se organi i akuzës do të arrinte në përfundim të drejtë duke kryer veprime të tjera hetimore⁴⁸, që do të plotësonin kuadrin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në lidhje me faktet e pretenduara në këtë kallëzim penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.4.2017.

29.7 Subjekti i rivlerësimit, në vijim, më datë **.11.2017, i është drejtuar sërish Gjykatës, me kërkesën për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2014.

29.8 Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.*** akti, datë **.4.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria...dhe kthimin e akteve Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve sipas detyrave të lëna në këtë vendim⁴⁹, *brenda 80 ditësh, duke filluar ky afat, pasi vendimi të marrë formë të prerë*. Ky vendim, pasi është ankimuar nga organi i akuzës, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.***, datë **.7.2018.

29.9 Subjekti i rivlerësimit, në vijim, më datë **.11.2018, i është drejtuar sërish Gjykatës, me kërkesën për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2014.

29.10 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.5.2019, sërish, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për pushim, kthimin e akteve Prokurorisë duke urdhëruar vazhdimin e mëtejshëm të veprimeve procedurale në dobi të hetimit të çështjes, veprime të cilat të përfundojnë brenda 90 ditëve, duke filluar ky afat, pasi vendimi të marrë formë të prerë. Ky vendim nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën **.6.2019.

29.11 Nga aktet rezulton se subjekti, në datën **.12.2019, në përfundim të detyrave të caktuara nga Gjykata, ka ridërguar kërkesën për pushimin e procedimit penal.

29.12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** Regj., Them., datë **.5.2020, ka vendosur sërish rrëzimin e kërkesës, kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve për një periudhë tjetër prej 90 ditësh, nga data që vendimi të marrë formë të prerë, *pasi vetëm kur të kryhen këto veprime, mund të arrihet në konkluzionin nëse në rastin konkret ka apo jo vepër penale*. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. ***, datë **.4.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e procedimit penal.

29.13 Komisioni, për sa më sipër, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar si vijon: (i) *Lidhur me pretendimet e denoncuesve se, nga verifikimi i dosjes duket se kërkesa për pushimin e çështjes në dhjetor 2019⁵⁰ dhe kërkesa për pushim e datës **.11.2018⁵¹ nuk i është komunikuar kallëzuesve. Shkresat përcjellëse nuk përmbajnë as datë dhe as numër protokolli;*

⁴⁸ Në detyrat e lëna nga Gjykata është kërkuar kryerja e veprimeve hetimore: 1- Verifikimi pranë ZVRPP Tiranë në lidhje me pronën e familjes ***; 2- Verifikimin e gjendjes juridike të pronës, si dhe hetimin e procedurës së kalimit në Këshillin Bashkiak të lejes së ristrukturimit, projektit të saj dhe fondet përkatëse; 3- Qëndrimi juridik i motivuar nga Bashkia, si dhe provueshmëria e faktit, nëse ky projekt është trajtuar edhe nga komuniteti i zonës.

⁴⁹ 1- Verifikimi i regjistrimit të pronës në ZVRPP Tiranë; 2- Procedura e kalimit në Këshillin Bashkiak të lejes së rikonstruksionit; 3- Nga ana e Prokurorisë pretendohet se janë bërë dëgjesa në komunitet për këtë projekt, por nga verifikimi i dosjes nuk rezulton ndonjë akt shkresor që të pasqyrojë këtë fakt; 4- Nuk janë administruar aktet shkresore të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Urban në Bashkinë Tiranë, si dhe kontratat e shitjes së pronës nga Ministria e Financave.

⁵⁰ Shkresa përcjellëse nuk përmban nr. prot., datë dhe vulë të organit të akuzës, por vetëm nënshkrimin e Drejtueses së Prokurorisë.

⁵¹ Shkresa përcjellëse nuk përmban nr. prot., datë dhe as nënshkrimin e Drejtuesit të Prokurorisë.

(ii) Nga verifikimi i dosjes duket se subjekti nuk ka përfunduar hetimet brenda afatit 90-ditor të përcaktuar në vendimin gjyqësor të datës **.5.2019 (i cili ka marrë formë të prerë në datën **.6.2019); (iii) Nga verifikimi i dosjes penale duket se nga ana e subjektit nuk janë kryer hetime të plota sipas detyrave të caktuara nga Gjykata, e cila i ka kthyer aktet 4 herë për hetime të mëtejshme.

29.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 20.9.2023, ndër të tjera, ka prapësuar se: (i) Pas përfundimit të një procedimi penal, prokurorët e dërgojnë dosjen te Drejtuesi i Seksionit, dhe nuk kanë më kontakt me dosjen dhe se nënshkrimi apo nisja e njoftimeve nuk është përgjegjësi e prokurorit; (ii) Lidhur me konstatimin e Komisionit se hetimet nuk janë përfunduar brenda afatit 90-ditor të përcaktuar në vendimin gjyqësor të datës **.5.2019 (i cili ka marrë formë të prerë në datën **.6.2019), subjekti e konsideron të drejtë si konstatim, për të cilin ka shpjeguar se muaji gusht është periudha e lejeve vjetore dhe janë kryer veprime hetimore që kanë kërkuar kohë⁵²; (iii) Sa i përket konstatimit të Komisionit se nga ana e subjektit nuk janë kryer hetime të plota, sipas detyrave të caktuara nga Gjykata, e cila i ka kthyer aktet 4 herë për hetime të mëtejshme, subjekti ka dhënë shpjegime për secilin nga vendimet e Gjykatës dhe, specifikisht, detyrat e lëna prej saj⁵³, të cilat janë zbatuar nga subjekti⁵⁴.

29.15 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] subjekti shpjegoi veprimet e kryera prej saj, në zbatim të vendimeve gjyqësore, si dhe arsyen e vonesës së veprimeve hetimore tej afatit të caktuar nga Gjykata. Ajo dha shpjegime mbi arsyet që kanë çuar në kthimin e çështjes nga Gjykata për hetime të mëtejshme. Nisur nga fakti se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës **.4.2021, ka pranuar vendimin e subjektit për pushimin e çështjes, mbetet i paqartë kthimi i akteve nga gjykata në mënyrë të përsëritur[...]. Komisioni ka çmuar të referojë pranë organit kompetent, ILD, për të vlerësuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me kallëzimin e regjistruar nr. ***, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

29.16 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime bindëse dhe nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, dhe pretendimet e saj nuk gjejnë mbështetje në rrethanat dhe aktet e paraqitura nga subjekti. Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se në kallëzimin penal të analizuar, subjekti ka treguar mungesë të aftësisë për të kryer me efekt procedura hetimore dhe procedura të tjera të tjera të sistemit të Prokurorisë, brenda afateve të përcaktuara, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë dhe mungesën e mbikëqyrjes së dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 73/2 dhe 3, si dhe neni 74/4 i ligjit nr. 94/2016.

⁵² Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës kopje të faqeve të librit të dorëzimit, në të cilat regjistrohen të gjitha shkresat që u nisen personave (kallëzues ose të kallëzuar), si dhe institucioneve të ndryshme, nga i cili rezulton se, më datë **.11.2018, është nisur shkresa për shtetasin ***, ***. Dhe, më datë **.12.2019, është nisur shkresa e dytë për vendimmarrjen tjetër për shtetasin ***, ***.

⁵³ Referohuni më gjerësisht prapësimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje të Komisionit.

⁵⁴ Subjekti ka depozituar shkresën nr. ***/** prot., datë **.9.2023, të ILD-së, ku sqarohet se kanë bërë ankim shtetasit ***, ***, ***, ***, (***) dhe ***, ***, (***), dhe nuk ka ankesa nga shtetasit ***, *** dhe ***, ***, ndërsa ankesa e bërë nga familja **, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016, është në proces verifikimi.

30. Denoncim i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave

30.1 Institucioni i DPPP-së ka informuar Komisionin se, në datën **.1.2020, ka marrë dijëni mbi me vendimin e prokurores Suela Salavaçi, “Për kthimin e llogarive bankare të sekuestruara”, të shtetasit **. **, drejtuar ** Bank, vendim në të cilin janë publikuar të dhëna të klasifikuara si “sekret shtetëror”, paraqitur në kuadrin e procedimit penal nr. **, viti 2019.

30.2 DPPP, në informacionin dërguar Komisionit, shprehet se ky fakt përbën shkelje flagrante të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar⁵⁵ dhe është parashikuar si vepër penale në nenet 294, “Tregimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar” dhe 295/a, “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”.

30.3 DPPP informon se ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe çmon të nevojshme të informojë Komisionin mbi këto fakte, të cilat, sipas denoncuesit, *përbëjnë provë, në mos të abuzimit, të paaftësisë profesionale të prokurores.*

30.4 Komisioni, në përfundim, në aktin *Rezultate të hetimit administrativ*, ka referuar se: *“Duket se pretendimet e denoncuesit, për mosmarrje në konsideratë të provave rrethanore apo mos verifikim të veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të kallëzuar lidhen me themelin e çështjes dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni”.*

30.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se dhe ky denoncim duhet vlerësuar nga Kolegji, së bashku me gjetjet e tjera, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

V. Kërkimi i ankimit

31. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

32. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

33. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

34. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

⁵⁵ Ligji është shfuqizuar me ligjin nr. 10/2023.

35. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 703, datë 28.9.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre Vëzhguesish Ndërkombëtarë (VN) të ONM-së, nr. 594/1 prot., datë 8.11.2023;
2. Gjetje nr. 398 prot., datë 27.6.2023, e VN të ONM-së.



International Monitoring Operation

*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*

Prot. No. 594/1

Tirana, 08 November 2023

To the

Public Commissioners

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", No. 5

Tirana

Albania

Case Number: **DC-P/TIR/1/20**

Assessee: **Suela *** Salavaçi**

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

according to

the Constitution of the Republic of Albania, Annex "Transitional Qualification
Assessment", Article B, paragraph 3, letter c.

Introduction

The Assessee Suela *** Salavaci holds the office of public prosecutor at the District Prosecution Office of Tirana. She is therefore assessed *ex officio* pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The Re-evaluation process was carried out by the Independent Qualification Commission (“IQC”) based on three criteria: assets, background and proficiency. At the end of the administrative investigation, the IQC notified the Assessee of its findings, shifting the burden of proof on a set of issues related to the asset assessment and the proficiency assessment.

The hearing took place on 26 September 2023 and following the deliberation as per Article 55, paragraph 5 of Law 84/2016 (“Vetting Law”), the Adjudication Panel decided to confirm the Assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law.

The decision was announced publicly on 28 September 2023.

Grounds for the recommendation

1. During her career the Assessee accumulated significant immovable and movable assets.

Reference is made, *inter alia*:

- to the apartment in Rruga *** *** (Tirana);
- to the apartment in *** ;
- to the pecuniary gifts received by her daughters.

The Assessee was also the co-holder of a bank deposit for a total value of 67.000 USD (although she alleged not to be the owner of the deposited money) and 10.000 EUR cash at home.

Furthermore, just shortly after the submission of the vetting declaration, the Assessee was donated by her parents the villa in Rruga **** where the whole family previously used to live.

The total value of the above assets (excluding the bank accounts) amounts to more than ALL 25.800.000.

On top of the above, the Assessee inherited around 5.000.000 ALL from her late father.

The Assessee explained during the investigation that such assets were created through the financial contribution of her parents. In the vetting and periodic declarations, the sources of income were normally described with the generic standard clause *“Family income, income from rent agreements, proceeds from sale of immovable properties, income from her brother in Italy, etc.”*

The IQC at the end of the investigation reached the preliminary conclusion that the Assessee and her parents lacked in significant amount lawful sources for the creation of these assets and burdened her to prove the contrary (although eventually it was decided to confirm her in duty).

2. The International Observers note that the parents’ alleged financial contributions to the Assessee were surprisingly steady, frequent and significant. Such claim – which basically implies that she lived at their expenses throughout her life - must be weighed with the greatest care, also considering that no donations were ever made by the parents to the Assessee’s brother during the same timeframe.

The International Observers therefore urge the Public Commissioners to independently and stringently assess whether the parents' sources of income existed, were lawful and were transferred to the Assessee.

3. The IOs further note that, even admitting the existence and lawfulness of the sources of income as claimed by the Assessee, these would not suffice to justify her assets, and her financial analysis would still be characterized by significant monetary shortcomings.

In fact:

- in March 2012 the Assessee signed an off-plan contract for the acquisition of an apartment in *** . The total price according to the vetting declaration was 72,000 EUR. Although the contract was in the Assessee's name, she declared that – as usual – the full price had been thoroughly paid by her parents.

However, she was unable to prove the existence of lawful sources for the last instalment, paid in March 2012.

The correlative financial shortcoming of 1,941,369 ALL must, therefore, be debited to the Assessee, who owned the asset¹.

- The Independent Qualification Commission, without sufficient evidentiary backup, in the final decision deviated from the standards set forth by law

¹ Such had been the conclusion reached by the IQC in the financial analysis attached to the results of investigation notified to the assessee.

However, this negative balance for the year 2012 was eventually mitigated by the IQC in the final decision, through the removal of the passive budget items related to the increase in bank deposits and to the payment of loan instalments, which had been previously included in the year 2012. The IQC final decision also removed the increase in bank deposits in the financial analysis of the year 2014.

This was without explanation, and it is striking that the same logic of elimination of the bank increases from the expenses was not applied to the financial analysis of the previous and following years.

9049/2003 (“HIDAACI law”) when considering the end-of-year savings declared by the Assessee in the PADs. This resulted in an unjustified advantage for the Assessee.

To this aim, the International Observers note that the end-of-year savings declared by the Assessee in the relevant box of the periodic annual declarations must be considered pursuant to the rule established in the HIDAACI law, according to which in the periodic declaration the declarant discloses additions or reductions of cash savings. Therefore, the calculation proposed by the IQC in the results of the administrative investigation was, in this regard, correct and should not have been altered in the decision. The claim of the Assessee that in the PADs of the years 2008-2016 she was not declaring *additions* to her cash savings, but merely the end-of-year *balance* of savings (aggregated in cash and in the bank) does not stand, because:

- The rule of Article 7 paragraph 1 of law 9049/2003 is clear in stating that the changes in savings (i.e. the additions or reductions) must be declared, and not the overall pecuniary balance at the end of the year.
- In order to justify a deviation from such legal standard, the Assessee should have provided strong evidence to corroborate her claim.
- In the present case, not only is there no such corroboration, but - on the contrary - the case file contains elements which point in the opposite direction. In fact:
 - When declaring the cash savings in the relevant box of the 2013 PAD, the Assessee described them as “Savings from *yearly* income”.

- Her bank statements show that on several occasions the end-of-year balance of the liquidities held in bank accounts alone was higher than the amount declared in the corresponding PADs. This is logically incompatible with the claim that in the PADs she was declaring the *overall* money balance, even more so considering that the PADs (in her own words) refer to the aggregate of banking savings and cash at home.
- The Independent Qualification Commission in its final decision failed to apply the evidentiary standards elaborated by the Special Appeal Chamber² for the calculation of travel expenses, thus reaching a more favorable result for the Assessee. Reference is made to the international travel tickets and holiday packages allegedly donated to her by friends. It does not appear that such gifts/preferential treatments were ever declared in the PADs.

Therefore, if we consider the cash savings declarations over the years as they should be by law, the financial analysis remains characterized by notable negative balances in the years 2007 (402.507 ALL), 2012 (1.279.460 ALL), 2014 (573.477 ALL) and 2015 (357.700 ALL), to which the minus corresponding to the instalment of the apartment in *** should be added (1.941.369 ALL). These figures might even be increased, depending on the modalities of calculation of the travels to Barcelona (2013) and USA (2014).

² SAC decisions no. 11/2019 (RJ), *** ***, para. 27.7 ff. The International Observers note that, even applying the very favorable standards elaborated by the Assessee, the overall cost of the 9 travels/holidays donated to the Assessee by her acquaintances (***, **, *** and others) would amount roughly to 5000 EUR.

The International Observers also note that accepting repeatedly significant gifts from third parties falls short of the ethical standards which, under national and international standards, would be expected from a public prosecutor. Reference is made to the CoE 'Budapest Guidelines on Ethics and Conduct for Public Prosecutors', 2005, and the International Association of Prosecutors (IAP) 'Standards of Professional Responsibility and Statement of the Essential Duties and Rights of Prosecutors', 1999.

Thus, even accepting that the Assessee's and her parent's monetary shortcomings should be compensated (when possible) with reciprocal surpluses, the financial analysis would still result in an overall negative outcome of 3.794.306 ALL³

4. The International Observers note that the financial situation would remain problematic even if the financial analysis should be conducted according to the methodology proposed by the Assessee (i.e. accepting that the declarations of cash in the PADs were referred to the overall cash balance). In this case, the overall minus would amount to 2,523,336 ALL, since the minus of 1,941,369 ALL from the third instalment for the apartment in *** should be added to the Assessee's minus of 581,967 ALL (as calculated by the Independent Qualification Commission after the hearing).

5. With regard to the proficiency assessment, the International Observers reckon that the decision of the IQC does not provide satisfactory analysis of the issues on which the burden of proof was shifted to the Assessee.

6. The above circumstances, in light of the standards applied by the Special Appeal Chamber in other cases where the financial shortcomings were even lower, justify an appeal from the Public Commissioner and the review of the case by the Special Appeal Chamber. In light of the foregoing, the International Observers

³ In particular, it seems that only in the years 2007 and 2015 the negative balance identified in the financial analysis of the Assessee could be compensated by corresponding positive balances in the financial analysis of her parents. On the other side, the negative balance identified in the financial analysis of the Assessee in the years 2012 (1.279.460 ALL) and 2014 (573.477 ALL) couldn't be compensated by the parents.

RECOMMEND

that the Public Commissioners appeal the decision of the Independent Qualification Commission of 28 September 2023 which confirmed the assessee Suela *** Salavaci in duty.

Tirana,

International Observer

International Observer



International Observer




International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*

Prot. No. 338

Tirana, 27 June 2023

To the
Independent Qualification Commission
Rruga e Kavajes no. 7
Tirana
Albania



Case Number **DC-P/TIR/1/20**
Assessee **Suela *** SALAVAÇI**

Finding Report

according to

Constitution of the Republic of Albania, Annex 'Transitional Qualification Assessment',
Article B, paragraph 3 letter b

and

Law No 84/2016 'On the transitional evaluation of judges and prosecutors in the Republic
of Albania', Article 49, paragraph 10.



Honourable Panel of the Independent Qualification Commission,

The assessee Suela Salavaçi investigated the criminal report registered at Tirana Prosecution Office on **07.2010, under criminal proceeding no. *** /2010 (following a complaint by Mr. *** ** against Ms. *** **).

The investigation was terminated, without charges being filed.

The undersigned International Observer deems that this file needs proper scrutiny by the Independent Qualification Commission, most notably in terms of completeness of the investigation.

Please find enclosed a copy of the criminal proceeding no. *** -2010.

Respectfully submitted,

International Observer

